



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 368/prot.
11

Tiranë, më 18.1.2021

UDHËZIM

Nr. 1, datë 18.1.2021

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 12.09.2018
“PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS
MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d” të pikës 2, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

- I. Në Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
 1. Në kreun IV bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Pas pikës 2 të shkronjës “C”, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:
“2/1 Mësuesi i specialitetit: 22 orë në javë.”.
 - b. Pika 3 e shkronjës “C”, ndryshon si më poshtë:
“3. Mësues i lëndëve të tjera: 22 orë në javë”
 - c. Pika 8 e shkronjës “E”, shfuqizohet.
 - d. Pas shkronjës “E”, shtohet shkronja “F”, me këtë përmbajtje:
“F. Organizimi i mëimit në shkollat sportive
 1. Orët teorike në lëndët: “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Futboll” dhe “Atletikë” zhvillohen me të gjithë klasën.
 2. Orët teorike në lëndët: “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Volejbol” dhe “Basketboll” zhvillohen në grupe, të cilat formohen me jo më pak se 7 nxënës.
 3. Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) për specialitetin “Futboll” zhvillohen me të gjithë klasën.

4. Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) zhvillohen me grupe sipas specialiteteve “Volejball” dhe “Basketboll”, sipas klasave.
5. Në specialitetin e “Peshëngritjes” dhe të “Atletikës”, sipas disiplinave, mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 6 nxënës.
6. Lënda “Sport ndihmës” zhvillohet në grupe të ndara sipas gjinisë djem dhe vajza, sipas klasave.”.

2. Në kreun V bëhen ndryshimet si më poshtë:

a. Pas pikës 15, shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15/1 Mësuesit të specialitetit në shkollat sportive, kur stërven grupet/ekipet sportive të shkollës për pjesëmarrje në takimet sportive (Kampionate Rajonale, Kombëtare dhe Ndërkombëtare) sipas kalendarëve sportivë të Federatave Shqiptare respektive, në përmbushje të veprimtarive sportive të parashikuara në Kurrikulën Sportive, i llogariten si ngarkesë mësimore 3 orë në javë.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

Evis KUSHI

